Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian

Projekt: Nxitja e parimeve kryesore për biznes dhe të drejta të njeriut

KOHEKT

Бизнис Конфедерација
Business Confederation

5 HAPA
PËR MENAXHIM ME NDIKIMET E BIZNESIT TUAJ MBI TË DREJTAT E NJERIUT

FILLIMI ME KONTROLLIN PARAPRAK TË TË DREJTAVE TË NJERIUT



Global Compact Network Germany

twentyfifty®

Global Compact Network North Macedonia

Shënim: Ky publikim është punuar me mbështejte financiare të Bashkimit Evropian. Qëndrimet e shprehura në këtë dokument janë qëndrime të Konekt dhe nuk i reflektojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Botues: Shoqata Konekt Shkup

Projekt: Nxitja e parimeve për biznes dhe të drejta të njeriut

Për botuesin: Nikica Kusinikova

Redaktor i botimit në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe: Nikica Kusinikova

Dizajn dhe shtypja e botimit në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe: Arcuss design Skopje

Përkthim nga gjuha angleze në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe – Lingva ekspert

Tirazhi: 200 në gjuhën maqedonase dhe 100 në gjuhën shqipe

Titulli origjinal: **5 Steps Towards Managing the Human Rights Impacts of sour Business: Getting Started with Human Rights Due Diligence, Global Compact Network Germany ,Twentyfifty Ltd.**

© **Global Compact Network Germany 2015**

Botuar nga::**Deutsches Global Compact Netzwerk**

Koncept dhe ekipi redaktues i tekstit origjinal

Larisa Ditrih | **twentyfifty Ltd.**

Medlin Koalik | **twentyfifty Ltd**.

Filip Blekman | **Global Compact Network Germany**

Faleminderim për:

Monika Behl I Kümmel & Co. GmbH, Ruth Hopfer-Kubsch I Studiosus Reisen München GmbH, Ulrike Upmeyer I HARTING KGaA, John Wiesel I itembase GmbH, Luke Wilde I twentyfifty Ltd. & Udo Woidneck I STEAG GmbH për komentet e tyre të dobishme dhe të dhënat që siguruan n për këtë publikim.

Konekt faleminderon rrjetin gjerman të Marrëveshjes globale për kontributin e tyre bujar për projektin „Nxitja e parimeve për biznes dhe të drejta“.

5 HAPA
PËR MENAXHIM ME NDIKIMET E BIZNESIT TUAJ MBI TË DREJTAT E NJERIUT

FILLIMI ME KONTROLLIN PARAPRAK TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

2019

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian

Projekt: Nxitja e parimeve kryesore për biznes dhe të drejta të njeriut

KONEKT

Бизнис Конфедерација
Business Confederation

Projekti “Nxitja e parimeve për biznes dhe të drejta të njeriut” (nr. referues EuropeAid/155319/DD/ACT/MK) është projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i implementuar nga Shoqata Konekt dhe Konfederata e biznesit. Projekti ka për qëllim të nxisë të drejtat ekonomike dhe sociale në sektorin privat në vendin tonë, nëpërmjet avancimit të biznesit dhe të drejtat e njeriut. Qëllimet specifike të projektit janë pjesëmarrja aktive e aktorëve relevantë në dialogun politik dhe rritjen e vetëdijes në lidhje me Parimet udhëheqëse të OKB-së, për biznes dhe të drejtat e njeriut (PUKB) si dhe kuptimin më të mirë, kapacitetet dhe dijen në lidhje me udhëheqësit e bizneseve dhe të drejtave të njeriut nga ana e biznes komunitetit. **www.konekt.org.mk**

Global Compact
Network North Macedonia

Rrjeti i marrëveshjes globale të Maqedonisë së Veriut është rrjeti i parë në vend, kushtuar përmirësimit të përgjegjësisë shoqërore kooperative e themeluar në vitin 2004. Ajo përfshin 16 anëtare aktive që përfaqësojnë kompani, organzata qytetare dhe aktorë të tjerë.

Global Compact
Network Germany

Marrëveshja globale dhe Rrjeti gjerman i Marrëveshjes globale (DGCN)
Marrëveshja globale ishte iniciuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2000. Ajo paraqet platformë strategjike dhe ndërkombëtare për mësim dhe dialog për biznes të qëndrueshëm dhe me përgjegjësi, i cili përfshin organizata qytetare, biznese dhe qeveri nacionale. Në bashkëpunim me partnerët, Marrëveshja globale e formon dialogun ndërkombëtar për qëndrueshmëri dhe zhvillim të strategjive afariste dhe mjete për arritjen e këtij qëllimi. Si platformë për mësim dhe dialog me më tepër aktorë, në kuadër të punës së vet, Marrëveshja globale mban ueb seminare, punëtori, trajnime, konferenca dhe forume teknike. Nëpërmjet rrjeteve lokale, të cilat organizojnë dhe mbajnë më tepër ngjarje, bizneset mund të kenë rol aktiv në formimin e dialogut. Rrjeti gjerman i Marrëveshjes globale është një nga më aktivët në botë me më tepër se 370 pjesëmarrës për momentin.
www.globalcompact.de

twentyfifty®
twentyfifty Ltd.

„twentyfifty Ltd“. është kompani për menaxhmen konsultim që punon me kompani multi nacionale dhe rrjedhat e vlerave të tyre globale, me qëllim të kutpjnë dhe të menaxhojnë me ndikimin shoqëror duke përdorur kornizën për të drejtat e njeriut. „Twentyfifty“ ka përvojë më tepër se dhjetë vjet në mbështetjen e kompanive, që të shndërrojnë përcaktimin e tyre për respektimin e të drejtave të njeriut në praktikë dhe të mplementojnë Parimet udhëheqëse të KB. „Twentyfifty“ punon në shumë shtete, me fokus të veçantë mbi xehetarinë dhe metalurgjinë, teknologjinë, turizmin, industrinë e përpunimit të ushqimit, industrinë e tekstilit etj.
„Twentyfifty“ i kombinon aftësitë themelore të zhvillimit organizues dhe përfshirjen e aktorëve, me njohejn thelbësore të KB dhe kornizat globale për të drejtat e njeriut. Kompania i mbështet klientët e saj në zhvillimin dhe menaxhimin me programe për përgjegjësi shoqërore, inkorporimin e respektimit të të drejtave të njeriut në strategjitë, politikat dhe proceset dhe ndërtimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve dhe mbështetjes gjatë zbatimit të praktikave afariste me përgjegjësi. **www.twentyfifty.co.uk**

PËRMBAJTJA

Hyrje 06

Pse më nevojitet qasje pro aktive ndaj të drejtave të njeriut? 09

HAPI 1
Krijo kuptimin 12

HAPI 2
Kartë e ndikimeve potenciale 17

HAPI 3
Identifikimi i proceseve ekzistuese dhe mangësive 22

HAPI 4
Përcaktoni aktivitetet tuaja me prioritet dhe identifikoni hapat e ardhshëm 28

HAPI 5
Kalimi në kontrollin rrjedhës paraprak 38

HYRJE

Hulumtimi me përgjegjësi i realizuar në kuadër të projektit "Nxitje e parimeve për biznes dhe të drejta të njeriut" përfshinte monitorim digjital të 59 kompanive nga lista e 200 kompanive më të mëdha dhe më të suksesshme në vend, si dhe anketë me mbi 100 kompani nga të gjitha industritë më të mëdha. Rezultatet tregun se pjesa më e madhe e kompanive kanë ndonjë formë të deklaratës për punë etike që përfshin kujdes për të punësuarit, klientët, mjedisin jetësor etj. Vetëm 28.8% e kompanive mbi të cilat është realizuar hulumtimi kryejnë analizë të rreziqeve në lidhje me të drejtat e njeriut, ndërsa vetëm 13,6% kanë qasje të planifikuar në këtë drejtim. Për më tepër informacione, vizitoni linkun në vijim: http://konekt.org.mk/pottiknuvanje-na-principite-za-biznis-i-chovekovi-prava/istrazhuvanje/ .

Si sipërmarrës, liderë afaristë, menaxherë ose të punësuar, dëshirojmë të jemi krenarë me kompanitë tona, të jemi pozitivë në lidhje me punën që e punojmë dhe në lidhje me **ndikimin që e kemi mbi komunitetet tona dhe shoqërinë më të gjerë.** Pa dallim nëse do ta arrijmë këtë me zhvillim të automobilit më të mirë që do të çojë njerëzit nga pika A në pikën B, me prodhimin e ushqimit të shëndetshëm me të cilin do të kënaqen blerësit ose me mundësimin e mjeteve financiare për dikë që të fillojë biznes, ne dëshirojmë të bëjmë dallim në jetët e të tjerëve dhe në jemi versioni jonë më i mirë kur puna jonë na mundëson të plotësojmë vlerat tona personale.

Si sipërmarrës me përgjegjësi, dëshirojmë të maksimalizojmë përfitimet pozitive nga biznesi jonë dhe të evitojmë ose të ulim në minimum ndikimet negative. Në mënyrë që të arrijmë këtë, shpesh herë mbështetemi mbi intuitën gjatë vendimmarrjes. Kështu, ajo që na duket e gabuar, shpesh është e gabuar. Edhe pse kjo qasje ka kredibilitetin e vet, sepse bizneset nga të gjithë sektorët dhe madhësitë më tepër punojnë në nivel ndërkombëtar, nuk është e lehtë të shihen ose të ndjehen ndikimet e vendimeve tona. Për këtë shkak edhe bizneset e vogla inkurajohen të vendosin **procese për kontrollim paraprak të të drejtave të njeriut**, me qëllim **të dinë dhe të mund të tregojnë**, se si ata i kuptojnë dhe i zgjedhin ndikimet e tyre mbi njerëzit dhe shoqërinë dhe të sigurojnë respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

Në këtë udhëzues është përcaktuar proces i thjeshtë dhe thelbësor për çdo kompani, por në veçanti për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, me ndihmën e të cilit ato mund të fillojnë me identifikimin e ndikimeve të tyre potenciale mbi të drejtat e njeriut të atyre njerëzve të cilët drejtpërdrejtë janë të prekur nga aktivitetet e tyre dhe atyre jetët e të cilëve ata i prekin nëpërmjet raporteve të tyre me furnizuesit ose persona të tjerë. Udhëzuesi Ju siguron mjete dhe qasje për të kuptuar çfarë është ajo që biznesi juaj tani më e bën për zgjidhjen

e këtyre ndikimeve dhe në cilët segmente ai mund të përmirësohet. Me këtë, udhëzuesi Ju ndihmon të ndërmerreni hapat tuaj drejt realizimit të kontrollit paraprak të të drejtave të njeriut.

Ai është strukturuar në 5 hapat themelorë në vijim:



Në kuadër të çdo hapi, udhëzuesi Ju siguron një sërë aktivitete të propozuara që mund ti provoni dhe ti përshtatni me nevojat e biznesit tuaj. Aktivitetet e propozuara janë ilustruar nëpërmjet shembllit të kompanisë fiktive "Çisto" SHPKNJP. Si mbështetje ndaj këtij publikimi është zhvilluar edhe online platforma që përmban referenca plotësuese dhe mjete për secilin hap dhe do të përditësohet rregullisht. Çdo herë kur janë të qasshme informacione plotësuese ONLAJN, kjo do të shënohet me shenjën:

„ÇISTO“ SHPKNJP

“Çisto” është biznes i vogël familjar në Maqedoninë e Veriut për prodhimin e produkteve për kujdes dhe higjienë personale për tregun vendor dhe tregjet e BE-së. Kompania mbështet mjedis pune i cili karakterizohet me respekt dhe mban raporte të gjata me klientët dhe furnizuesit. Klientët më të mëdhenj korporatave bëjnë revizion të punës së “Çisto”. Kohë më parë, një klient i madh nga BE-ja, kërkoi informacione plotësuese për qasjen e "Çisto" në lidhje me të drejtat e njeriut. Kjo shkaktoi diskutime interne në nivel të menaxhmentit më të lartë. Si rezultat i kësaj, një udhëheqëse e prodhimtarisë së “Çisto” fitoi mandat të grumbullojë informacione plotësuese dhe kompanisë ti paraqesë hapat e ardhshëm të mundshëm për menaxhmentin e kompanisë.

Ky udhëzues nuk përpiqet të përshkruajë se si të vendoset proces "i përkryer" për kontrollin paraprak të të drejtave të njeriut, por edhe të tejkalojë mangësitë e informacioneve dhe udhëzimeve që ekzistojnë te kompanitë të cilat e kanë filluar këtë proces. Udhëzuesi bazohet mbi përvojën prej më tepër se dhjetë vjet të kompanisë për menaxhim dhe konsultim „Twentyfifty" gjatë ofrimit të mbështetjes së kompanive për respektimin e të drejtave të njeriut, udhëzime për praktika të mira atje ku është përkatëse dhe shpërndarjen e mësimeve të mësuara nga kompanitë e Grupit për mësim korporativ për të drejtat e njeriut nga Rrjeti gjerman i Marrëveshjes globale. Në të, janë përfshirë edhe informatat kthyese të fituara nga analiza e përmbajtjeve të këtij doracaku nga ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha. Përpos kësaj, janë bërë edhe plotësime në bazë të vlerësimit të nevojave të kompanive në Maqedoninë e Veriut me qëllim të sigurohet zbatueshmëria në kontekst lokal. Nëse jeni të gatshëm ti bëni hapat e parë, vazhdoni dhe kaloni drejt hapit 1 në faqen 12. Nëse ju duhen pak më tepër informacione themelore ose sigurime, në pjesën në vijim janë dhënë më tepër detaje.

PSE MË NEVOJITET QASJE PROAKTIVE NDAJ TË DREJTAVE TË NJERIUT

Teknologjia dhe globalizimi ju mundësuan edhe kompanive të vogla të blejnë dhe të shesin në mbarë botën. Sa më të gjatë dhe më të komplikuar janë zinxhirët e furnizuesve dhe rrjedhat e vlerave të biznesit, aq më tepër bizneset largohen nga ndikimet e tyre mbi njerëzi që i prodhojnë, transportojnë, shesin ose blenë produktet e tyre. Në këto kushte, identifikimi i gjithë gamës së ndikimeve të cilat vendimet tona afariste mund ti kenë mbi të drejtat e njeriut, nuk është detyrë e lehtë.

Për shembull, furnizimi dhe importi nga vende, siç është Kina, ku shpenzimet për prodhim janë të ulëta, ju ndihmon kompanive të sigurojnë produkte me çmime të ulëta për klientët e tyre. Por, rritja e shpejtë e prodhimtarisë dhe standardet e dobëta për siguri rezultuan me ndikime serioze mbi mijëra punëtorë. Lajmet nëpër mediat në vendin tonë i theksojnë kushtet e këqija për punë në disa kompani vendore dhe investime të huaja. Gjithashtu, në Evropë, ngjashëm si edhe në Maqedoninë e Veriut, kompanitë ballafaqohen me sfida në lidhje me të drejtat e njeriut, siç është sigurimi i barazisë gjinore në vendin e punës.

Këto shembuj, tregojnë se bizneset mund të ndikojnë mbi të drejtat e njeriut pa marrë parasysh se ku punojnë, përfshirë edhe vendet ku ka ligje për rregullimin e detajuar të këtyre çështjeve.

Këto dhe nisma të tjera shkaktojnë interes të madh në publik për atë se si kompanitë e ushtrojnë biznesin e tyre në kuadër të të gjitha segmenteve dhe në lidhje me atë se si i transferojnë vlerat e tyre nëpërmjet zinxhirit të furnizuesve dhe në komunitetet ku veprojnë. . Bizneset më të mëdha që punojnë në nivel global dhe kanë identitet të fuqishëm të të brendit, fitojnë më tepër kritika nga mediat, konsumatorët, shoqëria civile dhe investuesit në bazë të ndikimeve të tyre mbi të drejtat e njeriut dhe ata i bartin pritshmëritë e tyre te bizneset e vogla dhe të mesëm në zinxhirin e tyre të furnizuesve. Për shkak se ekonomia jonë bëhet më e integruar në BE dhe në tregjet globale, qasja pro aktive në raport me respektimin e Parimeve udhëheqëse për të drejtat e njeriut, do të bëhet parakusht për punë për kompanitë tona që janë furnizues dhe partnerë afarist të kompanive të mëdha ndërkombëtare. Shqetësimi dhe nevoja për veprim me përgjegjësi më të madhe të bizneseve në ekonominë globale rezultoi me zhvillimin e kornizës globale me të cilën për herë të parë përcaktohet përgjegjësi shoqërore e definuar e ndërmarrjeve, për respektimin e të drejtave të njeriut.

Parimet udhëheqëse për biznes dhe të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara (KB), të miratuara nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut të KB në vitin 2011, e përcaktuan pritshmërinë themelore shoqërore se **bizneset do të respektojnë të drejtat e njeriut**, që do të thotë se nuk do të kenë ndikim negativ mbi të drejtat e njeriut. Të drejtat e njeriut sigurojnë një qasje standarde universale e cila qeverive dhe korporatave gjithnjë e më tepër publikisht ju prezantohet nga shoqëria civile. Parimet udhëheqëse të KB-së, tani më kanë ndikim mbi debatin për zhvillim të qëndrueshëm në BE dhe në krijimin e politikave nacionale.

Qeveritë në mbarë botën përpiluan Plan veprime Nacionale për zbatimin e tyre, ndërsa shumë biznese u obliguan se do ti respektojnë dhe filluan implementimin e tyre praktik. Klientët tuaj afarist ndoshta tani më kanë filluar të shtrojnë pyetje në lidhje me atë se si siguroheni se biznesi juaj i respekton të drejtat e njeriut.

Shkurtimisht, respektimi i të drejtave të njeriut do të thotë se biznesi juaj duhet të trajtojë të gjithë njerëzit që janë nën ndikimin e aktiviteteve tuaja. produkte dhe shërbime, me respektimin e dinjitetit të tyre njerëzor dhe liritë themelore. Nga kompanitë pritet të "**dinë dhe të tregojnë**" se i respektojnë të drejtat e njeriut në kuadër të punës së tyre të përditshme afariste. Plotësimi i përgjegjësisë për respektim, kërkon integrimin e respektimit të të drejtave të njeriut në punën afariste nëpërmjet politikave përkatëse dhe proceseve për kontrollin paraprak dhe krijimin e mekanizmave për denoncime, veprime dhe kompensimin e dëmeve të mundshme.

Nga kompanitë pritet në mënyrë pro aktive të identifikojnë ku mund të kenë ose kur kanë ndikim negativ mbi të drejtat e njeriut dhe të sigurojnë ndërmarrjen e masave përkatëse që ti parandalojnë, zbusin ose sipas nevojës ti mënjanojnë të njëjtat. Në fakt, kontrolli paraprak i të drejtave të njeriut është mjet pro aktiv me të cilin kompanitë në mënyrë sistemore mund të identifikojnë, vlerësojnë, parandalojnë dhe mënjanojnë ndikimet negative mbi njerëzit – nëpërmjet strukturave afariste, politikave proceseve dhe ajo që është më e rëndësishmja, sjellja dhe vendimet etike të përditshme të menaxherëve dhe të punësuarve.

Integrimi dhe respektimi i të drejtave të njeriut është proces rrjedhës i mësimit që do të duket ndryshëm për çdo kompani, në varësi të madhësisë dhe strukturës së kompanisë, lokacionit, produkteve, llojeve të pjesëve përkatëse dhe rreziqeve shoqëruese për shkaktimin e ndikimeve negative.

Nëse jeni pro aktiv në identifikimin dhe zgjidhjen e ndikimeve tuaja mbi të drejtat e njerëzve, do të keni përfitime afariste të qarta. Ato mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në:

- përgatitjen për ose plotësimin e kërkesave të rregullativës që do të bëhet obliguese,
- plotësimin e kërkesave të klientit,
- përmirësimin e menaxhimit me rreziqet,
- evitimin ose reduktimin e shpenzimeve menaxhuese, operative dhe juridike,
- mbrojtje e reputacionit,
- theksimi si partner i besueshëm në krahasim me konkurrentët,
- ndërtimi i raporteve më të mira dhe më të qëndrueshme me furnizuesit,
- përmirësimi i aftësisë për kredi,
- përmirësimi i shërbimeve për konsumatorët, në veçanti për grupet e konsumatorëve të cenueshëm dhe menaxhime cilësinë e produkteve,
- kënaqësia dhe qëndrimi në punë i punëtorëve.

Kontrolli paraprak i të drejtave të njeriut nuk kërkon të fillohet nga zero. Kompanitë tani më kanë vendosur procese të ndryshme mbi të cilat mund të mbi ndërtohen ndërsa përdorimi i "këndit të shikimit" për të drejtat e njeriut mund të rezultojë me njohuri të reja për proceset, siç janë standardet për sigurinë e produkteve, kontrollin e rreziqeve, menaxhim me personelin ose praktika në lidhje me mjedisin jetësor. Pesë hapat e përcaktuara në këtë udhëzues, ju ndihmojnë të hulumtoni si të keni progres në lidhje me qasjen tuaj ndaj kontrollit paraprak të të drejtave të njeriut.

HAPI 1

Krijo kuptimin

HAPI 2 | HAPI 3 | HAPI 4 | HAPI 5

Qëllimet e këtij hapi:

- Njoftimi me elementet themelore dhe me konceptet në lidhje me qasjen ndaj të drejtave të njeriut,
- Kuptimi se çdo të thonë të drejtat e njeriut në kontekstin e bizneseve dhe për sektorin tuaj,
- Kuptimi i koncepteve të ndikimeve dhe individëve dhe grupeve të prekura.

Qasja dhe aktivitete të mundshme:

Duhet të filloni me ndërtimin e dijes dhe kuptimit themelor për të drejtat e njeriut dhe madhësinë e ndikimeve të mundshme të cilat aktivitetet afariste dhe raportet afariste mund ti ushtrojnë mbi to. Ju rekomandojmë të njoftoheni me:

- Konceptin themelor për të drejtat e njeriut,
- Ndikimin që bizneset mund ta kenë mbi to dhe çështjet relevante me të drejtat e njeriut në sektorin tuaj.

Kjo do tu ndihmojë të përgatiteni për hartëzimin e ndikimeve potenciale mbi të drejtat e njeriut, të biznesit tuaj në hapin e ardhshëm.

Qasja e bizneseve ndaj të drejtave të njeriut, përfshin:

- Kuptimin se si mund të ndikojë biznesi juaj mbi njerëzit nëpërmjet aktivitete personale dhe marrëdhënieve afariste,
- Marrja parasysh e rreziqeve se mund tu shkaktojnë dëm njerëzve, jo vetëm rreziqet afariste,
- Marrja parasysh se disa individë ose grupe mund të ballafaqohen me rrezik të madh të lëndohen nga të tjerë, për shembull, fëmijë, pakica, persona me aftësi të kufizuara, etj.
- Kuptimi nëse dëmi nuk mund të kompensohet me aktivitete me ndikim pozitiv,
- Dhe në fund, parandalimi dhe ulja në minimum e ndikimeve negative dhe rritja e ndikimeve pozitive mbi njerëzit.

Çfarë janë të drejtat e njeriut?

Ideja për të drejtat e njeriut është e thjeshtë sa është edhe e fuqishme: Niset nga ajo se të gjithë njerëzit kanë të drejtë të trajtohen me dinjitet. Të drejtat e njeriut janë të drejta themelore dhe liri të cilat ju takojnë të gjithë njerëzve pa përjashtim.

çdo person ka të drejtë të gëzojë të drejta të njeriut pa diskriminim.

Ato përfshijnë të drejtat e punëtorëve, por nuk kufizohen vetëm në ato...

Të drejtat e njeriut kanë të bëjnë me të drejtat themelore të njeriut, të nevojshme dhe përfshijnë gamë të gjerë të çështjeve, siç janë siguria, banimi, uji, privatësia, diskriminimi, liria e shprehjes, kushtet e punës etj. Koncepti i të drejtave të njeriut bazohet mbi vlerat themelore, siç janë liria, respekti, barazia, dinjiteti, emancipimi dhe përgjegjësia.

Të drejtat e njeriut shpesh herë shprehen dhe garantohen me ligj, për shembull në formën e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe shndërrohen në ligje nacionale. Karta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (Deklarata universale për të drejtat e njeriut dhe dy pakte për zbatim) dhe konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) e përbëjnë bërthamën minimale të të drejtave të njeriut që njihen ndërkombëtarisht.

Të drejtat e njeriut janë grupe specifike të përcaktuara në marrëveshje të veçanta, siç është Konventa


për të Drejtat e Fëmijëve (CRC) ose Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW).).

Që të fitoni ndjenjën për madhësinë e të drejtave të njeriut, propozojmë të lexoni Deklaratën universale për të drejtat e njeriut të vitit 1948, dokumenti që paraqet revolucion në historinë e të drejtave të njeriut.

Vizitoni ueb faqen e Konekt dhe Qendrën e burimeve për biznes dhe të drejta të njeriut dhe kërkoni informacionet për biznes sektorin tuaj ose kompanitë nga sektori tuaj që të fitoni ndjenjë për cilat çështje në lidhje me të drejtat e njeriut bëhet fjalë. Titujt e mediave të paraqitura më poshtë kanë të bëjnë me disa shembuj për ndikimet e bizneseve mbi të drejtat e njeriut. Cilat nga ato mund të jenë relevante edhe për biznes sektorin tuaj?

Shembuj për ndikime të biznesit mbi të drejtat e njeriut të nxjerra nga mediat	Shembuj për të drejtat e njeriut të ekspozuar në rrezik
Veshje vrastare e mirë : sektori i tekstilit të ballafaqohet me rreziqet për mos pasjen e ujit	→E drejta për jetë →E drejta për standard jetësor përkatës →E drejta për ujë dhe pastërti , →E drejta për shëndet, ...
A do t ë mbijetojë privatësia epokën digjitale të mbikëqyrjes korporative?	→E drejta për privatësi →E drejta për lirinë e të menduarit, vetëdijes dhe religjionit →E drejta për lirinë e shprehjes dhe mendimit, ...
Maqedonia e Veriut tokë pjellore për robër ekonomik	→E drejta mos i nënshtrohet robërisë, nënshtrimit ose punës me dhunë →E drejta mos i nënshtrohet torturës ose trajtimit të ashpër, jo human ose nënçmues, ose dënimit. →E drejta të gëzojë në kushte të drejta dhe të volitshme për punë,
Më alarmant për momentin është informacioni për përfaqësimin radikalisht të ulët të përfaqësimit të grave në industrinë e teknologjive informatike	→E drejta të gëzojë kushte të drejta dhe të volitshme për punë →E drejta për jetë familjare →E drejta për barazi para ligjit, dhe të drejta kundër diskriminimit, ...
Rreziqet potenciale për ndotjen e mjedisit jetësor me hapjen e minierave të reja për bakër, ar dhe argjend në pjesën juglindore	→E drejta për jetë →E drejta për shëndet →E drejta për standard jetësor përkatës →E drejta të gëzojë në kushte të drejta dhe të volitshme për punë →E drejta për shëndet
Marketing dhe reklamim të fëmijëve: probleme të ndërlidhura	→Të drejta të fëmijëve .....

Në grafikun I më poshtë janë dhënë shumicë individësh dhe grupe mbi të drejtat e të cilëve do të mund të kryhet ndikim (negativ) me aktivitetet afariste ose raportet të një kompanie. Prej tyre disa me siguri do të kenë sfidë më të madhe të dëgjohet zëri i tyre dhe do të jenë me rrezik më të madh të lëndohen në krahasim me të tjerët. Shembuj për këtë janë fëmijët që jetojnë në komunitetet rreth kapaciteteve prodhuese ose punëtorëve migrantë të punësuar nga furnizues ose partnerët afaristë. Mendoni në lidhje me atë se cili nga ky grup ka mundësi më të madhe të preket nga puna në sektorin tuaj! A mungon ndonjë grup?



I . Palë potencialisht të prekura

ÇISTO SHPKNJP

Pas konsultimeve me "Konekt" dhe leximit të artikujve në mediat, udhëheqësja e prodhimtarisë së "Çisto" zbuloi se:

- Çështjet lidhur me të drejtat e njeriut për "Çisto" nuk kanë të bëjnë vetëm me standardet për punë por edhe me tema të ndryshme plotësuese, për shembull, siguria dhe marketingu i prodhimit, të drejtat e kompanive lokale të prekura me ndërtimin e tokës, ose ekzistimin e furnizuesve;
- Në kuadër të procesit të aderimit në BE, Maqedonia e Veriut do të përgatisë plan veprim kombëtar, dhe në atë mënyrë kompanitë që i zbatojnë Principet udhëheqëse të KB-së do të kenë përparësi kur do të paraqitet në tregun e BE-së. Konkurruesi publikoi politikë për përgjegjësinë shoqërore në ueb faqen e kompanisë duke përfshirë edhe obligim për respektimin e të drejtave të njeriut.

Nëse dëshironi të hyni pak më thellë në temën ndikimet e bizneseve mbi të drejtat e njeriut, mund të konsultoheni me një sërë resursesh hyrëse. Për shembull, publikimi "„Respektimi i të drejtave të njeriut – udhëzues hyrës për bizneset" ju jep shembuj për studime të rastit dhe informata themelore për më shumë të drejta njerëzore, p.sh. të drejtat e fëmijëve në vendin e punës ose të drejtën e standardit jetësor adekuat (akomodim, ushqim dhe ujë). Publikimi i BE-së „Biznesi im dhe të drejtat e njeriut ju jep pyetje të cilat duhet t'i parashtroni në lidhje me 15 situata afariste të cilat mund të shpijnë në rrezik nga ndikimet negative mbi të drejtat e njeriut dhe listën e të drejtave të njeriut, me shembuj të shkurtër për atë se mund që ndërmarrjet, nëse nuk janë të kujdesshme, të ndikojnë mbi to.

Për më shumë informata, vizitoni faqen për Diagnostika e kapaciteteve për respektimin e të drejtave të njeriut në gjuhën maqedonase https://mr-sorgfalt.de/mk/hrcd/

HAPI 2
Karta e ndikimeve potenciale

Qëllimet e këtij hapi:

- Përgatitja e pasqyrës në sferat kryesore për ndikimet potenciale të kompanisë suaj mbi të drejtat e njeriut dhe marrëdhëniet e saj afariste;
- Identifikimi i grupeve të njerëzve që mund të preken nga aktivitetet dhe marrëdhëniet tuaja afariste.

Qasja dhe aktivitetet e mundshme:

Ndikimet mbi të drejtat e njeriut (potenciale ose reale) mund të dalin nga puna e biznesit tuaj ose të jenë të lidhura me prodhimtarinë e prodhimeve ose shërbimeve tuaja, ose përdorimin e tyre në kuadër të të gjithë rrjedhës së vlerave. Që të keni një pasqyrë, përpiquni që të krijoni një hartë të thjeshtë të aktiviteteve dhe marrëdhënieve tuaja kryesore afariste, duke filluar nga lëndët e para, prodhimtaria dhe logjistika, e gjer te livrimi i prodhimit ose shërbimit te klienti (pa u harruar kthimi ose riciklimi nëse kjo është pjesë e punës së biznesit tuaj).

Pastaj, në bazë të njohurive tuaja nga hapi 1, mendoni se cilat grupe të njerëzve mund të preken në kuadër të kësaj rrjedhe të thjeshtë të vlerave ose në cilën mënyrë mund të ushtrohet ndikim mbi të drejtat e tyre. **i** Shqyrtoni shembullin për pasqyrë të tillë të ndikimeve potenciale të "Çisto" që është dhënë më poshtë, si inspirim për atë si të vazhdojë.

Është e dobishme që të publikohet se cilat janë individët dhe grupet që mund të ballafaqohen me rrezik më të madh të jenë nën ndikim (negativ) nga biznesi juaj. Për shembull, ato mund të kenë kërkesa të veçanta, ose që to ekziston mundësi se do të kenë vështirësi për t'i shprehur nevojat e tyre, ose janë tradicionalisht jashtë rrjedhave shoqërore. Si pikë fillestare mund t'i shfrytëzoni grafikët I dhe II dhe pasqyrën e "'Çisto" të dhënë më poshtë.

Harta juaj fillestare e ndikimeve do të jetë e papërsosur dhe me të do të identifikoni sfera në të cilat ju nevojitet informata plotësuese. Kjo është vetëm pikë fillestare dhe ju do ta përmirësoni pasqyrën tuaj gjatë hapave vijuese.



II. Grupe nën rrezik potencial më të lartë

- Mund t'i shfrytëzoni publikimet nga mediat, informatat nga organizatat civile ose baza tjera të të dhënave që t'i kuptoni më mirë sferat kryesore të ndikimeve potenciale mbi të drejtat e njeriut lidhur me aktivitetet dhe marrëdhëniet e kompanive tuaja. Ato, gjithsesi, do të varen nga ve-primtaria dhe nga vendet në të cilat punoni. Për shembull, një kompani farmaceutike mund të ndikojë mbi shëndetin e konsumatorëve të tyre përmes prodhimeve të tyre. Për një kompani të ushqimit dhe pijeve, ku-shtet për punë në zinxhirin bujqësor të prokurimeve do të jenë shumë relevante. Në sektorin e informatikës dhe teknologjisë së komunikimit, privatësia dhe liria e të shprehurit e shfrytëzuesve do të jenë sferë e rëndësishme të ndikimit potencial.
- Nëse dëshironi pasqyrë të shpejtë të çështjeve kryesore lidhur me të drejtat e njeriut në nivel të prodhimit ose në nivel të vendit „CSR Risk Check" kjo vegël mund të jetë e dobishme për ju. Në fushën e portokall-të më poshtë janë cekur edhe burime tjera që sigurojnë informata për çështje lidhur me të drejtat në nivel të vendit Këto raporte dhe baza të të dhënave nuk janë dizajnuar për klientë afaristë, dhe do të duhet t'i interpretoni informatat në lidhje me aktivitetet dhe marrëdhëniet tuaja afariste konkrete dhe të shihni se si mund të ndikojnë ato mbi njerëzit. Për shembull, nëse organet qeveritare kryejnë diskriminim sistematik ndaj femrave ose pakicave, ka shumë gjasa që këto grupe të jenë të ekspozuara në rreziqe më të larta në vendin e punës ose si pjesë e bashkësive lokale që janë prekur nga stabilimenti i ri i prodhimtarisë ose projekti investues në vendin konkret.
- Nëse tanimë keni kontakte të mira, dhe nëse kjo është e realizueshme për ju, në këtë fazë të hershme mund të filloni të komunikoni në mënyrë joformale me sindikatat, organizatat relevante civile, asociacionet e biz-nesit ose organet qeveritare relevante që të kuptoni çfarë janë mendimet e tyre në lidhje me ndikimet potenciale për sektorin dhe kompaninë tuaj dhe ta përmirësoni hartën tuaj të ndikimeve në bazë të informatave të marra.

Burime të informatave për rreziqet për të drejtat e njeriut

- Diagnostika e kapaciteteve për respektim të të drejtave të njeriut në gjuhën maqedonase
- Kontrolli i rrezikut CSR (rreziqe sektoriale dhe të lidhura me vendin)
- Kërkim në Qendrën e resurseve për biznese dhe të drejta të njeriut sipas vendit ose sektorit
- Indeksi i të drejtave të punëtorëve sipas vendit i publikuar nga ITUK
- Raportet për gjendjet e të drejtave të njeriut sipas shteteve që i publikon Stejt departamenti i SHBA-së
- „Amnesti Interneshënëll“ dhe „Hjuman Rajts Voç“ (raporte sipas vendeve)

Pasqyra e ndikimeve potenciale mbi të drejtat e njeriut përmes shembullit të “Çisto”

“Çisto” prodhon kozmetikë për higjienë personale, me punëtorë me kualifikim të lartë të punësuar me orar të pacaktuar në Maqedoninë e Veriut. Lëndët e para i prokuron nga vendi dhe nga jashtë. Shpeshherë, sasi të vogla të lëndëve të para prokurohen nga fermat e vogla bujqësore lokale dhe pyjore. Disa nga lëndët e para duhet zgjidhen me kujdes. Partnerë tjerë të rëndësish-

	PROKURIMI I LËNDËVE TË PARA/ZINXHIRI I PROKURIMEVE
SFERAT E NDIKIMEVE POTENCIALE MBI TË DREJTAT E NJERIUT	▪ Ekziston mundësia e ekzistimit të kushteve të rrezikshme për punë dhe punë të fëmijëve në disa vende nga të cilat prokurohet; ▪ Shëndeti dhe siguria gjatë punës në fermat dhe rafineritë; ▪ Kushtet për punë të punëtorëve të përkohshëm/sezonalë në fermat, p.sh: punë jashtë orarit, tepricë teknologjike dhe largim nga puna pas përfundimit të zezonës; ▪ Ndikimi i shfrytëzimit të pesticideve mbi shëndetin e punëtorëve në fermat dhe bashkësitë bujqësore; ▪ Ndikimi mbi ekzistimin, p.sh. të ujit të pijshëm/qasja në tokën e bashkësive bujqësore; ▪ Siguria e transportit dhe tregtisë potenciale të njerëzve dhe kontrabanda e materieve joligjore; ▪ Mitë dhe korrupsion në sektorin e transportit; ▪ ....
GRUPET E PREKURA POTENCIALE	▪ Punëtorët, bashkësitë (fermat, rafineritë); ▪ Punëtorët e ndërmjetësuesve; ▪ Punëtorët e dhënësve të shërbimeve për logjistike.
GRUPET QË JANË VEÇANËRISHT TË EKSPOZUAR NË RREZIK	▪ Punëtorët sezonalë; ▪ Fëmijët; ▪ Punëtorët femra dhe pakicat në zonat rurale; ▪ ...
FUNKSIONE AFARISTE RELEVANTE	▪ Prokurime, menaxhimi me cilësinë, logjistika...
MARRËDHËNIET AFARISTE RELEVANTE	▪ Ndërmjetësuesi; ▪ Dhënësi i shërbimeve për logjistikë; ▪ Prokuruesi i materialeve të zyrës; ▪ Prokurues të pajisjes IT;

ëm afaristë janë dhënësit e shërbimeve për logjistikë dhe prokurues të ambalazhit për paketim. **Udhëheqësja e prodhimtarisë së "Çisto" përgatit pasqyrë preliminare të sferave kryesore të ndikimit potencial të "Çisto mbi të drejtat e njeriut, përfshirë edhe informatat për grupet e prekura potenciale dhe grupe që në veçanti janë të ekspozuara në rrezik:**

PRODHIMTARIA NË MAQEDONINË E VERIUT	**SHITJA DHE DEDIKIMI I FUNDIT**
▪ Diskriminimi i punëtorëve në bazë të gjinisë dhe përkatësisë së ndryshme etnike; ▪ Siguria e të dhënave dhe privatësia e punëtorëve; ▪ Shëndeti dhe siguria në punë në lokacionet e prodhimit; ▪ Ndotja dhe menaxhimi me mbeturina; ▪ Orari i punës dhe kushtet për punë, ▪ Pagesa e rrogës minimale veçanërisht për nënkontraktues potencialë/ punëtorë sezonalë/pakica etnike (p.sh. nënkontraktues që i ndërtojnë zyrat e reja, mbajtës të higjienës); ▪ ...	▪ Siguria dhe keqpërdorimi i produkteve; ▪ Marketing joetik ▪ (shfrytëzimi i fotografive diskriminuese); ▪ ...
▪ Punëtorë në Maqedoninë e Veriut; ▪ Punëtorë të partnerëve afaristë.	▪ Nënkontraktues/të punësuar në shitje; ▪ Të punësuar te dhënësit e shërbimeve; ▪ Shfrytëzuesi i fundit.
▪ Punëtorë femra, punëtorë me invaliditet, persona me obligime familjare, punëtorë të rinj, pakica etnike (mbajtës të higjienës); ▪ ...	▪ Të rinjtë dhe shfrytëzues të fundit me invaliditet, femra punëtore, punëtorë me invaliditet, persona me obligime familjare; ▪ ...
▪ Shëndet dhe siguri, menaxhim me cilësinë, resurse njerëzore, hulumtues dhe zhvillim, revizion i brendshëm.	▪ Marketingu, shitja, menaxhimi me cilësinë, mbështetja e shfrytëzuesve;
▪ Prokurues të ambalazhit; ▪ Dhënës të shërbimeve (p.sh. mbajtës të higjienës); ▪ Dhënës të shërbimeve të IT-së; ▪ Punëtorë për sigurim; ▪ Agjencia për punësim të përkohshëm.	▪ Agjentë të jashtëm për shitje.

HAPI 3
Identifikimi i proceseve ekzistuese dhe mangësive

Qëllimet e këtij hapi:

- Harta e proceseve të menaxhimit që kompania juaj i ka vendosur për t'u përballur me ndikimet e mundshme dhe për t'i identifikuar mangësitë dhe nevojat për informatat shtesë;
- Komunikimi me personat e tjerë në biznesin tuaj për të përmirësuar dhe përfunduar hartën tuaj fillestare.

Qasja dhe aktivitetet e mundshme:

Tani keni njohuri themelore të çështjeve lidhur me të drejtat e njeriut që janë të rëndësishme për biznesin tuaj. Hapi tjetër është të përpiloni një hartë të proceseve që i keni vendosur për t'i parandaluar dhe zbutur ndikimet e mundshme që i keni identifikuar. Kjo do t'ju ndihmojë të kuptoni: nëse proceset ekzistuese janë të përshtatshme duke i pasur parasysh ndikimet e mundshme në biznesin tuaj; a ka mangësi që duhet të mënjanohen për t'u siguruar që në mënyrë efikase e keni parandaluar shfaqjen e ndikimeve të dëmshme, ose të bëheni të vetëdijshëm për ndodhjen e tyre me qëllim që të mund të përballeni me to. Burimet e mundshme të informatave janë: politikat korporative dhe kodet e sjelljes, statistikat dhe kërkimi i mendimit të të punësuarve, procedurat e shëndetit dhe sigurisë, politikat e furnizuesve, proceset dhe rezultatet e revizioneve, sistemet e menaxhimit me mjedisin jetësor, mekanizmat e ankesave nga shfrytëzuesit, etj.

Për ta përmirësuar hartën tuaj, duhet t'i përfshini sektorët dhe kolegët e tjerë në kompaninë tuaj. Mund ta shfrytëzoni këtë mundësi për ta rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm mbi ndikimet e mundshme kryesore që i keni identifikuar dhe të siguroheni që të kuptuarit tuaj për proceset ekzistuese mbështetet nga ekspertiza dhe përvoja e kolegëve tuaj nga sektorët përkatës. Gjatë procesit do të jeni në gjendje t'i edukoni kolegët tuaj dhe të merrni më shumë informata rreth spektrit të ndikimeve që mund të dalin nga biznesi juaj.

- Mund të filloni me hartimin e listës së funksioneve kryesore të biznesit që mund të jenë të përfshira në përballjen me ndikimet e të drejtave të njeriut të identifikuara më parë, si dhe proceset që duhet të shqyrtohen. Mund ta shfrytëzoni Grafikën III si frymëzim.



III. Pasqyra e funksioneve dhe çështjeve të zgjedhura korporative relevante që ato i mbulojnë

Kjo mund t'ju ndihmojë në komunikimin me kolegët tuaj:

- Shqyrtoni format / strukturat e mbledhjeve të caktuara siç janë: mbledhjet me përgjegjësi shoqërore (OOP) ose punëtoritë që mund t'ju shërbejnë si bazë për komunikimin tuaj me kolegët.
  Nëse është e mundur, organizoni punëtori ku do t'i përfshini kolegët nga sektorët dhe funksionet e ndryshme. Hapni diskutim ose jepni mundësi për të dërguar informata kthyese përmes postës elektronike ose telefonit. Nëse është e mundur, takohuni personalisht me kolegët.
- Gjatë përgatitjes për mbledhjet, mund të jetë e dobishme të mblidhni argumente përse të përballurit me çështjet lidhur me të drejtat e njeriut është i rëndësishëm për biznesin tuaj. Këto mund të lidhen me disa nga përfitimet e mundshme të biznesit, të përshkruara në faqen 10.
- Kur do ta prezantoni temën shfrytëzojeni terminologjinë që e kanë të njohur kolegët tuaj. Kjo do të thotë që ju nuk duhet të flisni për "të drejtat e njeriut" me secilin prej tyre. Marrëdhënia e drejtë, respekti, vlerat korporative, integriteti, shëndeti dhe siguria, siguria e produkteve ose të qenit biznesmen i përgjegjshëm... Këto mund të jenë pikënisje për të biseduar me kolegët e ndryshëm dhe pjesë të biznesit tuaj. Videot e shkurtra për prezantimin e biznesit dhe të drejtave të njeriut ose për të siguruar një pasqyrë vizuale të grupeve / shembujve relevante për ndikimet mbi të drejtat e njeriut që janë relevante për sektorin tuaj mund t'ju ndihmojnë që tema të jetë më e kapshme për kolegët tuaj.
- Në komunikimin me kolegët tuaj theksoni se keni nevojë për pikëpamjet dhe ekspertizën e tyre për të vazhduar edhe më tutje për të qenë një biznes i përgjegjshëm që prodhon rezultate të mira. Askush nuk dëshiron që puna e tij të ketë ndikime negative tek njerëzit e tjerë. Nëse kolegët tuaj bëhen të vetëdijshëm për rreziqet ekzistuese dhe mundësitë praktike për përmirësim, ata me siguri do të reagojnë pozitivisht.
- Mos harroni t'i përfshini kolegët tuaj në përcaktimin e hapave të ardhshëm dhe t'i njoftoni mbi përparimin - respektimin e të drejtave të njeriut dhe do të funksionojë vetëm nëse të gjithë në kompani janë të vetëdijshëm për ndikimet e mundshme të praktikave të përditshme të biznesit.

- Me ndihmën e kolegëve tuaj, përmirësojeni dhe përfundojeni listën tuaj të ndikimeve të mundshme dhe keni njohuri në proceset e menaxhimit që kompania juaj i ka vendosur për t'u përballur me to. A janë të vetëdijshëm për ndikimet e mundshme që i keni identifikuar? A kanë ata të shtojnë ndonjë ndikim në listën tuaj? A kanë njohuri mbi incidentet e kaluara ose situatat në të cilat ndikimet e mundshme janë shmangur? Çfarë bëjnë për

të parandaluar shfaqjen e ndikimeve negative në punën e tyre të përditshme? Çfarë kontrolle dhe procese ka vendosur kompania juaj? A ka sugjerime në lidhje me atë se çfarë janë rezultatet e tyre dhe mangësitë e mundshme?

- Së bashku me kolegët tuaj, dokumentoni informatat në pasqyrë ose grafik. Mund të duket e ngjashme me pasqyrën "Çisto" të dhënë në vazhdim. Në këtë moment, do të filloni t'i identifikoni mangësitë, përkatësisht ku keni ndikim të mundshëm në të drejtat e njeriut dhe ku nuk keni, ose ku masat që janë vendosur nuk janë të mjaftueshme për t'i parandaluar ose zbutur ato. Këto mangësi mund të paraqesin rreziqe për biznesin tuaj (të reputacionit, ligjor, operativ, etj.), si dhe rreziqe për njerëzit që preken potencialisht prej tyre.
- Kujtohuni se shumica e proceseve tuaja ekzistuese nuk do të adresohen drejtpërdrejt në të drejtat e njeriut, dhe as që gjithnjë do të jenë të shkruara ose të përcaktuara formalisht. Kjo jo domosdoshmërisht duhet të jetë problem, por duhet të siguroheni që keni vendosur një nivel të duhur të kontrolleve dhe masave mbrojtëse për të parandaluar shfaqjen e ndikimeve negative në të drejtat e njeriut, të siguroheni që do të jeni të informuar nëse diçka shkon keq dhe se do të jeni në gjendje të përballeni me veprime të duhura. Kontrolli paraprak i gjendjes së të drejtave të njeriut nuk do të thotë që do të jeni i përsosur që nga fillimi, ose se nuk do të gaboni. Qëllimi është të vendosni kontrolle dhe të synoni për përmirësime të vazhdueshme.

> "Fabrika e çimentos Usje" është e përkushtuar t'i respektojë të drejtat e njeriut në të gjitha fushat e punës sonë: të punësuarve, partnerëve dhe komunitetit më të gjerë. Këtë e bëjmë përmes politikave, punës dhe praktikave tona të komunikimit. Respektimi i të drejtave të njeriut është shndërruar në vlerat dhe politikat thelbësore të USJE të harmonizuara me Grupacionin Titan. Në vendosjen e qasjes sistemike na ndihmon anëtarësimi ynë në Marrëveshjen Globale. Kështu, qysh nga viti 2008 punojmë dhe njoftojmë me përkushtim në fushën e të drejtave të njeriut dhe të punës, mjedisin jetësor, menaxhimin etik dhe antikorrupsionin".“
> **Znj. Magdalena Sllavejkova, menaxhere për resurse njerëzore dhe OOP, Fabrika e çimentos Usje**


Kur do t'i kontrolloni proceset tuaja të menaxhimit mund ta shikoni edhe diagnostikën e kapaciteteve për t'i respektuar të drejtat e njeriut në gjuhën maqedonase, një vegël i vetëvlerësimit me 22 pyetje. Mund t'ju ndihmojë t'i vlerësoni kapacitetet tuaja të menaxhimit në lidhje me elementët kryesore të përgjegjësisë korporative për t'i respektuar të drejtat e njeriut në kuadër të spektrit nga "reaktivë" deri në "promotor i të drejtave të njeriut" .

Pasqyrë e proceseve dhe mangësive në "Çisto"

Në punëtori me përfshirjen e funksioneve të ndryshme, përfaqësues të "Çisto" nga sektorë të ndryshëm bënë analizën fillestare të proceseve aktuale dhe mangësive që të përfshijnë disa fusha kryesore të ndikimit mbi të drejtat e njeriut në Çisto:

FUNKSIONE AFARISTE TË PREKURA	FUSHA TË NDIKIMEVE TË MUNDSHME MBI TË DREJTAT E NJERIUT	CILAT MASA JANË PËRCAKTUAR PËR VLERËSIMIN / PARANDALIMIN / MENAXHIMIN ME RREZIQE TË KËTILLA
Prokurime, menaxhim me cilësi	**Kushte për punën e fermave dhe rafinerive**	▪ Të punësuarit e "Çisto" për menaxhim me cilësi, kohë pas kohe bëjnë vizita të drejtpërdrejta në ferma të vogla bujqësore ose rafineri, por nuk bëjnë këqyrje eksplicite në kushtet për punën e fermave dhe rafinerive, ▪ Marrëveshjet me ndërmjetësuesit përfshijnë klauzola në të cilën është përcaktuar se obligohen të respektojnë 10 parimet e Përgjigjes globale të KB, ▪ Nuk ka informacione nëse "Çisto" pjesërisht prokuron lëndë të para minerale për shembull me certifikatë nga ▪ I gjithë vaji prej palmave, prokurohet nga tregtarë që janë anëtarë të "Tryezës së rrumbullakët për vaj palme të qëndrueshme", ▪ Realizohet trajnim vjetor për prioritetet për prokurim të "Çisto" dhe strategjia për zhvillim dhe produkte, ▪ ...
Burime njerëzore	**Diskriminimi i grave / personave me përgjegjësi familjare, pakica etnike**	▪ Revizorët e jashtëm ndonjëherë parashtrojnë pyetje për mundësitë e barabarta, ▪ Menaxhmenti i kompanisë promovon politika të dyerve të hapura, ▪ Formalisht, ka sindikatë të punëtorëve, por nuk është shumë aktive dhe ka rol të kufizuar, ▪ Trajtimi i drejtë në proceset e punësimit gjendet lartë në agjendën e udhëheqjes së BNj, ▪ Janë përcaktuar masa të veçanta për kujdes ndaj punëtoreve shtatzëna, ▪ ...
Cilësi, shitje dhe marketing	**Siguria e produkteve**	▪ Siguria e produkteve është pjesë esenciale e cilësisë së "Çisto" dhe prioritet i lartë i kompanisë, ▪ Kontrolle të rregullta të cilësisë, ▪ Revizione të jashtme dhe të brendshme, ▪ Nuk janë denoncuar incidente, ▪ Për keqpërdorimin e produkteve dhe instruksioneve për etiketimin e produkteve , agjentët për shtije komunikojnë me klientët.

MANGËSI TË IDENTIFIKUARA	NEVOJA PËR INFORMACIONE PLOTËSUESE
▪ Nuk ka sektor / person përgjegjës për temën, ▪ Nuk kontrollohet vlefshmëria e informacioneve që i sigurojnë ndërmjetësuesit, ▪ Nuk janë vendosur procese për kuptimin e gjendjes për të drejtat e njeriut në vendet e reja të prokurimit ose rreziqe në lidhje me ndërmjetësuesit, ▪ Nuk ka Kod të sjelljes ose proces për revizion për ndërmjetësuesit ose firmat, ▪ Sektori për prokurime i kryen prokurimet sipas çmimit dhe cilësisë së produktit, për momentin nuk kërkon plotësimin e kritereve sociale plotësuese gjatë rangimit të ofertave,	▪ Marrja e informacioneve plotësuese për proceset e vlerësimit të cilësisë. Sa shpesh udhëtojnë kolegët në lokacionet prej nga bëhen prokurimet? Çfarë informacione kanë mbledhur ata? A kanë mundësi ndonjëherë të bisedojnë me të punësuarit në firma ose në rafineri? ▪ Si shkon procesi i marrjes së ekzemplarëve? A e dini se si njoftohen fermerët e vegjël për vonesat ose ndryshimin e çmimeve?
▪ Në doracakun për punëtori nuk ka informacione për jo diskriminim . mundësi të barabarta, ▪ Nuk është e qartë nëse politika e dyerve të hapura është mekanizëm përkatës në mënyrë që të punësuarit të paraqesin ankesat e tyre, duke pasur parasysh se nuk ka raste të denoncuara, ▪ Diversiteti etnik i pa mjaftueshëm...	▪ A ka deklarata ose dokument me shkrim i cili qarte tregon qëndrimin e kompanisë për mundësi të barabarta / jo diskriminim? ▪ Si është përqindja e grave / burrave në pozita udhëheqëse që punojnë me orar pune të shkurtuar? ▪ A ka hulumtime në lidhje me mendimin e kompanisë që përfshin jo diskriminim / mundësi të barabarta?
▪ Nuk janë identifikuar	▪ Nuk janë identifikuar



Qëllimet e këtij hapi:

- Në bazë të analizës tuaj për mangësitë, përcaktoni prioritetet që duhet ti bëni në vijim, në mënyrë që të përmirësoni menaxhimin me ndikimet e biznesit tuaj mbi të drejtat e njeriut,
- Dizajnoni plan konkret për kompaninë.

Qasja dhe aktivitete të mundshme:

Pasi të identifikoni fushat kryesore të ndikimit të biznesit tuaj mbi të drejtat e njeriut dhe mangësitë e sistemit tuaj për menaxhimin e tyre, mënjanimi i tyre mund t'ju duket si detyrë e madhe dhe mos jeni të sigurt se si të vazhdoni. Në hapat paraprak, sigurt do të identifikoni disa përmirësime të dukshme, të shpejta dhe të drejtpërdrejta, për shembull ku lehtë do të mund të integroni ndonjë element që mungon në ndonjë politikë ose pako për trajnim të kuadrit relevant. Për disa çështje të tjera ndoshta do të mendoni se ende nuk keni kohë të mjaftueshme që të dini nëse dukuria e ndikimeve potenciale të cilat i keni identifikuar janë parandaluar vërtet ose janë zbutur në praktikë.

Duke pasur parasysh burimet, kompania juaj do të duhet të përcaktojë prioritete mbi hapat e ardhshëm dhe të identifikojë fushat kryesore ku do të duhet të bëjë vlerësim thelbësor të ndikimeve tuaja faktike dhe mbi rezultatet e proceseve tuaja të menaxhimit, në praktikë. Në këtë hap janë dhënë disa qasje dhe opsione se si ta bëni këtë. Kjo do të duhet tu mundësojë të përgatisni plan konkret të kompanisë në lidhje me të drejtat e njeriut, në të cilin do të përcaktohen qëllimet afatshkurta dhe afatgjata, korniza kohore fillestare dhe personat që janë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave të nevojshme për plotësimin e qëllimeve tuaja.

Gjatë zbatimit të qasjes me fokus mbi të drejtat e njeriut, në mënyrë përkatëse duhet të përfshini të gjitha ndikimet tuaja. Kur do të vendosni prej nga të filloni, prioritet duhet tu jepni fushave për të cilat ekziston rrezik i madh të kenë ndikim serioz mbi të drejtat e njeriut. Kjo ka të bëjë me atë se:


- Sa seriozisht do të kishte ndikuar mbi të drejtat e njeriut? (për shembull jeta e njeriut është në rrezik),
- Sa do të ishte shtrirja e ndikimit? (sa persona do të ishin prekur),
- Sa vështirë do të ishte të mënjanohet ndikimi i dëmshëm? (a mund të kompensohet / mënjanohet / pastrohet ose do të ishte e pa kthyeshme për shembull lëndim ose dëm).

Kuptohet, në praktikë, mundësia e paraqitjes së ndikimeve të dëmshme, do të ndikojë mbi përcaktimin e prioriteteve. Ai do të jetë më i lartë në shtet me rezultate të dobëta në lidhje me gjendjet e të drejtave të njeriut ose në zinxhirin e prokurimeve ku ka më tepër punë manuale me punëtorë me kualifikime të larta ose kur punët me biznes partnerë të cilët kanë rezultate të dobëta ose kapacitete të kufizuara. Punë të tjera që duhet të merren parasysh, të cilat do të kishin mundur t'ju ndihmojnë të përcaktoni ku të fokusoni aktivitetet tuaja, për shembull janë: sa janë mundësitë tuaja të ndikoni mbi furnizuesit tuaj ose mbi partnerët tuaj afarist të ndryshojnë praktikat e tyre ose sa janë të angazhuar kolegët tuaj në fushë të caktuar afariste dhe sa janë të përgatitur të shqyrtojnë dhe përmirësojnë praktikat e tyre.

Prandaj, për kompani të ndryshme do të përdoren pika fillestare të ndryshme, që të përcaktohet në se të fokusohemi në të ardhmen dhe për se të bëni analizë më të thellë. Operator turistik i cili është aktiv në Jugun global, ndoshta do të dojë të fokusojë vëmendjen e vet në dy ose tre vende me rrezik të lartë, te të cilat organizon udhëtime. Ofrues i shërbimeve për TI me gamë të gjerë të produkteve me probleme të mundshme mbi privatësinë, fillimisht do të fokusohet në produktet me të cilat lidhen rreziqet më të mëdha për ndikim negativ.

Matrica e vendeve me prioritet furnizues të "ÇISTO"

Në bazë të hapave paraprak, me mbështetje të Konekt "Çisto" përcaktoi se rreziqet më të mëdha për ndikimet negative për momentin burojnë nga furnizimi i saj me lëndë të para. Në punëtorinë me ekipin për prokurime "Çisto" e krijoi këtë matricë të vendeve me prioritet të cilat janë furnizuesit e tij kryesorë:




Sasia e lidhur e prokurimit > 1.000 l > 500 l > 100 l

Y- bosti *ka të bëjë me nivelin e ndikimeve negative potenciale mbi të drejtat e njeriut në zinxhirin e prokurimeve të "Çisto" në atë vend (përcaktuar sipas asaj që "Çisto" prokuron nga shteti dhe situata me të drejtat e njeriut në atë vend)*

X – boshti *ka të bëjë me rëndësinë e tregut të prokurimeve për "Çisto" (që do të thotë se sa janë me rëndësi mallrat e prokuruar për "Çisto" për prodhimin e vajrave esenciale / qasja në vende alternative për prokurim)*

Interpretimi i matricën së vendeve prokuruese me prioritet, nga "Çisto"

Bazuar në prioritizimin e vendeve "Çisto" vendosi të ndërmarrë aktivitetet në lidhje me vendet prokuruese / zinxhirët e prokurimit në katër kuadratet, në vijim:



Qasje e ngjashme mund të përdoret për t'ju dhënë përparësi furnitorëve, produkteve, shërbimeve ose vendeve të punës dhe ngjashëm, në varësi të asaj çfarë është relevante për biznesin tuaj. Ofruesi i shërbimeve financiare, për shembull, ndoshta do të dojë të fillojë me përcaktim të prioriteteve në mënyrë përkatëse, në raportet afariste.

Në bazë të prioriteteve tuaja dhe përkufizimit të hapave të ardhshëm, do të duhet të dokumentoni planin tuaj në format të qasshëm, që do t'ju ndihmojë ju dhe kolegëve tuaj të keni progres. Aktivitetet të cilat me siguri do të rezultojnë nga vlerësimi juaj në lidhje me mangësitë dhe nga vendosja e prioriteteve, do të përfshijnë:

- Ndryshime në mënyrën se si udhëhiqni biznesin që të evitoni ndikimin potencial ose të vërtetë dhe rreziqe të ndërlidhura,
- Trajnimi i individëve të cilët duhet të identifikojnë dhe të kenë kujdes për rreziqe të caktuara,
- Nivel i zmadhuar i ndjekjes së mediave dhe burimeve të tjera të informimit për çështjet në lidhje me të drejtat e njeriut,
- Ndryshim, përmirësim, përditësim të proceseve aktuale për menaxhim me shitjen, prokurimin, angazhimin në komunitet dhe ngjashëm (ose ndërprerjen e tyre),
- Formimi ose vendosja e politikave të reja,
- Hulumtime të mëtutjeshme për ti kuptuar më mirë ndikimet,
- Identifikimi i kritereve sipas të cilave do të matni progresin tuaj gjatë arritjes së këtyre qëllimeve.

„Farmahem ekziston në tregun maqedonas dhe shënon zhvillim të vazhdueshëm tani më 30 vite pikërisht për shkak të përcaktimit të fuqishëm për punën me përgjegjësi shoqërore dhe punë të qëndrueshme. E kuptojmë rëndësinë e të drejtave të njeriut dhe kushtojmë vëmendje të madhe në avancimin e vazhdueshëm të raporteve me të punësuarit, furnizuesit dhe përdoruesit e produkteve dhe shërbimeve tona, i ndërmarrim të gjitha masat për siguri dhe shëndet gjatë punës, angazhohemi për luftë kundër korrupsionit dhe fer biznes, ndërsa gjithnjë me qëllim të ndërtojmë relacione afatgjate bazuar mbi profesionalizëm, besim dhe lojalitet. Njëkohësisht, një nga parimet udhëheqëse të biznesit tonë është edhe kujdesi për mjedisin jetësor dhe natyrën" -
Menaxhere e Farmahem znj. Vinka Tanevska, Drejtoreshë, Farmahem

Gjatë këtij procesi dhe gjatë përpilimit të hapave të mëtutjeshëm, mund tu ndihmojë të komunikoni me organizata siç është Konekt, shoqata në industri, iniciativa të sektorit, iniciativa nga më shumë aktorë ose rrjete të tjera relevante, siç është rrjeti i Marrëveshjes globale të Maqedonisë së Veriut. Kërkoni mundësi për dialog relevant ose ngjarje për të këmbyer praktikat më të mira ose sfidat në implementimin me kompani të tjera ose konkurrentë.

Draft plan i “Çisto” për të drejtat e njeriut

“Çisto” krijoi planin fillestar i cili është paraqitur më poshtë me qëllime konkrete, përgjegjësi dhe afate. Mund ta përdorni si model në mënyrë që të përpiloni planin tuaj në bashkëpunim me kolegët tuaj relevantë.

Nr.	Fusha	Qëllimi	Aktiviteti
1	Menaxhim	Të drejtat e njeriut janë integruar në proceset kryesore për analizën e rreziqeve	Integrimi i kritereve për respektimin e të drejtave të njeriut në procesin e zgjedhjes së vendit për prokurime
2			Strukturimi dhe intensifikimi i konsultimeve me Sindikatën.
3			Integrimi i kritereve për respektimin e të drejtave të njeriut në procesin e zgjedhjes së firmave ndërmjetësuese.
4	Trajnim	Trajnim dhe sensibilizimi i të punësuarve	Përpilimi i ueb faqes për strategjinë e “Çisto” për përgjegjësi shoqërore dhe qëndrueshmëri ekologjike dhe ndikimi mbi funksionet afariste të “Çisto”.
5			Integrimi i informacioneve për të drejtat e të punësuarve dhe politika e dyerve të hapura në doracakun për të punësuarit.
6			...
7	Kuptimi i ndikimeve	Përmirësimi i kuptimit të ndikimeve në zinxhirin e prokurimeve	Zbatimi i pilot auditimit me furnizues me rrezik të lartë;
8			Dërgimi i delegacioneve të vogla në Indi dhe organizimi i këmbimit të grupeve të interesuara dhe organizata qytetare lokale.

	Përgjigje:	Fillim	Afati	Gjendja e implementimit	Komente
	Prokurime, Znj. Maneva	05/2018	09/2020	Nuk ka filluar	Në bashkëpunim me grupin për qëndrueshmëri të “Çisto” dhe hulumtim dhe zhvillim
	Prokurime	06/20XX	12/20XX	Nuk ka filluar	Në bashkëpunim me Cilësi dhe hulumtim dhe zhvillim
	...	...	...	...	
	Burime njerëzore	05/20XX	10/20XX	Nuk ka filluar	Mendoni në lidhje me formatet / ueb faqe aktuale të cilat i ofrojnë rrjetet e bizneseve ose iniciativave nga më tepër aktorë
	Burime njerëzore	07/20XX	08/20XX	Nuk ka filluar	
	...	...	...	...	
	Prokurime	05/20XX	12/20XX	Nuk ka filluar	
	Kontakt për të drejtat e njeriut	06/20XX	12/20XX	Nuk ka filluar	

STUDIM I RASTIT Studiosus



Forum për dialog me aktorët lokalë në Nikaragua. Burimi: Studiosus Reisen

„Studiosus" është operator turistik gjerman i specializuar për udhëtime studimore për udhëtime studimore moderne. „Studiosus" ka 320 të punësuar në Gjermani dhe punon me 570 ciceron turistik në destinacione turistike në mbarë botën. Përgjegjës për vendime kryesore në lidhje me menaxhimin me qëndrueshmërinë (përfshirë edhe aspektin e të drejtave të njeriut) „Studiosus" është "**komitet për harmonizim shoqëror**" më shumë sektorial i cili përbëhet nga përfaqësues të sektorëve për turizëm, marketing, marrëdhënie me publikun, ciceron turistik dhe sisteme për menaxhim si dhe përfaqësues të menaxhmentit të lartë...

Në vitin 2011 u publikua studimi i organizatës civile për ndikimet potenciale mbi të drejtat e njeriut në sektorin e turizmit. Udhëheqësi për cilësi dhe qëndrueshmëri i „Studiosus" e përdori këtë analizë për të krijuar **formular për vetë vlerësim në „Excel"** në mënyrë që më mirë ti kuptojë ndikimet potenciale të „Studiosus" mbi të drejtat e njeriut në çdo shtet ku punon. Vlerësimi u dërgua te ekipet e vendeve dhe të ekipet për prokurime. Udhëheqësitë e vendeve u inkurajuan të përdorin takimet ekzistuese dhe konferencat për biseda konfidenciale sy më sy me ofruesit lokalë të shërbimeve me qëllim që marrin informacione relevante. U krijua udhërrëfyes i shkurtë për biseda me qëllim tu sigurojë mbështetje gjatë këtij procesi.

Gjatë evaluimit të vetëvlerësimit u theksuan fushat potenciale të ndikimit mbi të drejtat e njeriut, në të gjitha vendet në të cilat në përgjithësi punon „Studiosus", si vijon:

- kushtet e punës në sektorin transportues dhe të hotelerisë (autobusë dhe hotele),
- puna e fëmijëve / mbrojtja e fëmijëve,
- mbrojtja e pakicave nga diskriminimi,
- mbrojtja e privatësisë,
- ndikime mbi ekzistencën e komuniteteve lokale (në veçanti ushqim dhe ujë dhe përfshirje në komunitet).

Në drejtim të epilogut nga vetëvlerësimi për të drejtat e njeriut, komiteti i „Studiosus" vendosi të **rishikojë dhe të përditësojë proceset kryesore që të zbusë disa nga ndikimet e identifikuara potenciale**. Kjo ishte në lidhje me bashkëpunimin me ofruesit lokal të shërbimeve, rishikimin e konceptit të programit dhe informacione të cilat u janë dhënë përdoruesve. Procesi i ndryshimeve u realizua në bazë të diskutimeve të brendshme me sektorë të tjerë relevant, që u zhvilluan disa herë. . Njëkohësisht, tema për të drejtat e njeriut ishte integruar në trajnimet ekzistuese të të punësuarve dhe në seminare vjetore për ciceron turistik të „Studiosus".

Procesi i rishikimit rezultoi me **matricë të përditësuar të qëndrueshmërisë me masat në lidhje me të drejtat e njeriut për secilën njësi të kompanisë** (për shembull transport, hoteleri, ciceron turistik, destinacion për udhëtim) e cila rregullisht përditësohet. Shembuj për masat e vendosura gjatë viteve të kaluara përfshijnë:

- Grupe pune nga më shumë sektorë dhe funksione të ndryshme në kompani për përfshirjen e klauzolave sociale në marrëveshjet me ofruesit e shërbimeve,
- Përditësim të rregullt të katalizatorëve për përdoruesit që të përfshihen informacione në lidhje me të drejtat e njeriut,
- Krijimi i e – mail adresës për paralajmërim në lidhje me të drejtat e njeriut,
- Krijimi i Kodit të sjelljes së furnizuesve,
- Krijimi i Kodit të sjelljes në lidhje me veprimin përkatës gjatë fotografimit.
- Krijimi i Kodit të sjelljes për ciceronët turistik të „Studiosus" për takime gjatë udhëtimeve,

Kalimi në kontrollin rrjedhës – paraprak

Qëllimi i këtij hapi:

- Implementoni planin tuaj dhe vendosni proces të vazhdueshëm që do të mundësojë kontrollin rrjedhës – paraprak.

Qasje dhe aktivitete të mundshme:

Duke i ndjekur hapat e përmendura paraprakisht, me sukses i keni bërë hapat e parë për kontrollin paraprak të të drejtave të njeriut. Në hapat paraprak i keni identifikuar ndikimet potenciale relevante nga biznesi juaj mbi të drejtat e njeriut dhe vlerësuat sa janë të mira proceset tuaja për parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative. I keni identifikuar dhe keni vendosur prioritete për aktivitetet konkrete që mund ti ndërmerrni për të përmirësuar punën tuaj. Më pas do të implementoni dhe do të monitoroni implementimin e planit tuaj. Kjo do të përfshijë identifikimin e indikatorëve që do tu ndihmojnë të matni përmirësimin gjatë punës suaj, përkatësisht numrin e të punësuarve të trajnuar për të drejtat e njeriut ose numrin e marrëveshjeve për prokurime të cilat janë realizuar sipas kritereve për të drejtë të njeriut. Kremtoni suksesin dhe përmirësimet dhe filloni të komunikoni për identifikimin e rreziqeve dhe aktiviteteve tuaja.

Proceset e kontrollit thelbësor rrjedhës paraprak, do të udhëzohet drejt përmirësimit të vazhdueshëm mbi të gjithë elementet e paraqitur në Grafikun IV. Kjo do të thotë krijimin e sistemeve dhe proceseve që do të jenë përkatëse për natyrën dhe vëllimin e biznesit tuaj dhe që do të mundësojë të njoftoheni me ndryshimet në profilin tuaj të ndikimeve me kalimin e kohës, të reagoni për atë, të siguroni korrigjime në rast se diçka nuk është ashtu siç duhet, të monitoroni punën tuaj dhe të komunikoni për atë që e punoni me grupe potencialisht të prekura dhe me aktorë të tjerë relevantë.



IV. Komponentë të kontrollit paraprak të të drejtave të njeriut

Duhet të kërkoni mundësi për përfshirjen e të drejtave të njeriut të cilat i ofron kontrolli i sistemeve aktuale, përkatësisht vendosjen e procedurave të reja për harmonizim, mundësia për investim në shtet të ri, zhvillim të produktit të ri ose përditësimin e përgjithshëm të politikës së kompanisë. Sigurisht, kontrolli paraprak rrjedhës kërkon angazhim në kuadër të biznesit dhe jashtë tij, në veçanti me ato grupe të njerëzve të cilët potencialisht janë të prekur nga biznesi juaj. Ky angazhim do tu japë informacione për ndikimet tuaja të vërteta, nëse aktivitetet për parandalim funksionojnë, nëse proceset tuaja janë të mjaftueshme dhe si më mirë të bëni korrigjimin, kur diçka nuk është siç duhet. Këmbimi i rregullt i informacioneve me të tjerët në sektorin tuaj ose me kompani në situatë të ngjashme me qëllim të mësoni nga përvojat tuaja, mund tu ndihmojë me kalimin e kohës të përmirësoni dhe të përshtatni qasjen tuaj. Para së gjithash, duhet të kuptoni se kontrolli paraprak i të drejtave t ë njeriut është proces i mësimit dhe baza e tij është pro aktive, hulumtim i vetëdijshëm i ndikimeve dhe se si ato mund të menaxhohen, që do të përmirësohet me kalimin e kohës.

Eliminim i mangësive në praktikat tuaja aktuale afariste dhe vendosje e praktikave të vazhdueshme për kontrollin paraprak, me siguri do të përfshijë disa nga masat e përcaktuara në tabelën më poshtë. Në faqen 40 janë shënuar hapat e ardhshëm potencial të “Çisto”.

Vendosja e praktikave të vazhdueshme të kontrollit paraprak

Kontrolli rrjedhës paraprak do të kërkojë...	Shembuj për implementim dhe çfarë mund të përfshijë
Ndarja e përgjegjësisë së qartë dhe sigurimi i fokusit rrjedhës në lidhje me temën të drejtat e njeriut	▪ Caktimi i përgjegjësisë ndaj individit – personit për kontakt për të drejtat e njeriut – ose grup pune i (përhershëm) i përzier, me linja të qarta të përgjegjësisë në nivel udhëheqës. Ky person / grup mund të veprojë si konsulent i brendshëm, koordinator ose folës në temën të drejta të njeriut në kuadër të biznesit dhe jashtë biznesit. Personi juaj për kontakt duhet të vazhdojë me angazhimin e filluar dhe tu raportojë në lidhje me progresin, kolegëve relevantë, të punësuar dhe palëve të interesuara.
Vlerësimi i ndikimit tuaj të vërtetë mbi të drejtat e njeriut nga aspekti i rreziqeve dhe mangësive të identifikuara në Hapin 3 dhe 4	▪ Siguroni informata plotësuese për situatën e njerëzve të cilët potencialisht janë të prekur nga biznesi juaj, për shembull, të punësuar tek ofruesi i shërbimeve se komunitete të cilët janë të prekur nga zinxhiri juaj i furnizuesve. ▪ Përpiquni të vendosni lidhje me partnerë afarist dhe punëtorët në zinxhirin tuaj të furnizuesve ose komuniteteve, për shembull, kur udhëtoni në vendet për furnizim ose prodhim. ▪ Kuptoni më tepër për iniciativa ndër – sektoriale (institucione, biznese, organizata qytetare etj.) nëpërmjet grumbullimit të informacioneve në terren. ▪ Pyesni ndërmjetësuesit / furnizuesit për praktikat e tyre që të siguroheni se mundi dhe të drejtat e njeriut, respektohen .
Rishikimi i proceseve kryesore të menaxhimit nga aspekti i identifikimit të rreziqeve dhe mangësive	▪ Ndryshoni furnizuesit tuaj ose mënyrën në të cilën bëni një aktivitet të caktuar afarist që të evitoni rrezikun ose të parandaloni ndikim. ▪ Rishikim të furnizuesve me rrezik të lartë, analizë e kritereve për seleksionimin e partnerëve të tjerë afaristë, përmirësimin e mekanizmave për parashtresa ose ankesa nga të punësuarit. ▪ Përpilimi i Kodit të sjelljes për partnerët afaristë dhe furnizuesit, përfshirë edhe kërkesën për respektimin e të drejtave të njeriut. ▪ Integrimi i të drejtave të njeriut në proceset aktuale për analizë dhe rreziqe.
Inkurajimi i kulturës së mësimit dhe përmirësimit nëpërmjet mundësive të rregullta për informim të punëtorëve dhe përkufizimin e qëllimeve të qarta për kompaninë	▪ Krijoni mjet për mësim të pavarur për të punësuarit, komunikoni rregullisht për progresin tuaj gjatë takimeve me të punësuarit, trajnoni ekipin tuaj për prokurime, mblidhni praktikat më të mira dhe shpërndani ato në mënyrë interne, dërgoni të punësuarit kryesorë në trajnime relevante. ▪ Theksoni angazhimin tuaj për respektimin e të drejtave të njeriut në deklaratën tuaj publike, të kompanisë, për vlerat. ▪ Krijoni një ose disa indikatorë kryesorë të perfromancave për sektorë relevantë.
Kërkimi aktiv i informatave hyrëse dhe dalëse dhe informatave kthyese nga aktorë të jashtëm dhe palë të interesuara që më mirë të kuptoni ndikimet tuaja dhe ankesat potenciale dhe të përmirësoni veprimin në lidhje me ankesat	▪ Vendosni kontakt me përfaqësuesit e organizatave sindikaliste dhe organizata civile në shtetin amë dhe në vendet e prodhimit. ▪ Përsëri mendoni se si mund të komunikojnë palët e prekura me biznesin tuaj në rast të ankesave ose parashtresave në lidhje me ndikimet negative mbi të drejtat e njeriut dhe si do të kishit mundur të përmirësoni qasjen e tyre drejt këtyre mekanizmave. ▪ Publikoni përmbajtje relevante në ueb faqen tuaj. ▪ Merrni pjesë në takime ose në trajnime të shoqatave nga industria.

Vlerësimi rrjedhës paraprak do të kërkojë ...	Hapat e radhës të ÇISTO
Caktimi i përgjegjësisë së saktë dhe sigurimi i fokusit rrjedhës në temën të drejtat e njeriut	Menaxhuesja e prodhimtarisë së "Çisto" e cila e ka filluar procesin do të jetë përgjegjëse për udhëheqjen e hapave vijues dhe do të veprojë si person për kontakt për të drejtat e njeriut. Grupi për qëndrueshmëri i "Çisto" që përbëhej nga përfaqësues i burimeve njerëzore, furnizime, cilësi dhe menaxhmenti i lartë do të mbikëqyrë procesin dhe rregullisht do të takohet për të vlerësuar progresin e "Çisto" në raport me planin e tyre për të drejtat e njeriut.
Vlerësim i ndikimit tuaj të vërtetë mbi të drejtat e njeriut nga aspekti i rreziqeve dhe mangësive të identifikuara në Hapin 3 dhe 4	"Çisto" vendosën se do të kishin dashur të kuptojnë diçka më tepër rreth kushteve të punës të firmave të vogla në Indi. Ata kontaktuan me organizatat civile lokale të Indisë (GO) dhe dërguan delegacion të vogël në terren. Së bashku me përfaqësuesit vizituan firmë të vogël e cila bën prodhimtari për "Çisto" e zgjedhur nga (GO) dhe organizuan diskutime me punëtorët dhe anëtarët e komunitetit. Bisedat konfirmojnë më tepër rreziqe të identifikuara gjatë hulumtimit në zyrë, në Maqedoninë e Veriut. "Çisto" kupton për mundësinë të marrë pjesë në vlerësimin e ndikimit mbi të drejtat e njeriut në nivel të sektorit në Indi të realizuar nga konzorciumi i organizatave qeveritare, afariste dhe qytetare.
Rishikimi i proceseve kryesore të menaxhimit nga aspekti i identifikimit të rreziqeve dhe mangësive	Në bazë të rezultateve dhe këqyrjeve të grumbulluara gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit "Çisto" i analizon qëllimet në lidhje me rezultatet e sektorit të vet për furnizime. "Çisto" kërkon partnerë logjistik afarist në Maqedoninë e Veriut ti sigurojnë kompanisë dokumentacion për praktikat e punës dhe pagesën e pagave minimale para nënshkrimit të marrëveshjes së re. Vlerësimi i rregullt i vendimeve kryesore afariste në raport me rrezikun nga ndikimet negative potenciale mbi bashkëpunimin me sektorë relevantë paraqet pjesë të punës së grupit për qëndrueshmëri të "Çisto" me mbështetje të personit për kontakt për të drejta të njeriut.
Inkurajimi i kulturës në mësim dhe përmirësimi nëpërmjet mundësive të rregullta për informimin e të punësuarve dhe përkufizimin e qëllimeve të qarta për kompaninë	Në bazë të nevojave për informacione, të identifikuara në vlerësimin e mangësive, sektori për resurse njerëzore i "Çisto" do të krijojë program më të detajuar për trajnime për ekipin për prokurime dhe cilësi në bashkëpunim me personin për kontakt për të drejta të njeriut.
Në mënyrë aktive kërkoni informacione hyrëse dhe thyese nga aktorë të jashtëm dhe të interesuar në mënyrë që më mirë ti kuptoni ndikimet tuaja dhe ankesat potenciale dhe të përmirësoni veprimin në lidhje me ankesat	Detajet për personin për kontakt për të drejtat e njeriut të "Çisto" janë publikuar në ueb faqen e kompanisë dhe janë shtypur në faqen e fundit të vizit kartave të kompanisë. Tani menaxhuesja e prodhimit të "Çisto" kohë pas kohe merr pjesë në forume të rëndësishme për dialog. Ajo kontakton me përfaqësues të organizatave civile që të dëgjojnë si ata i kuptojnë rreziqet e sektorit të "Çisto" dhe pritshmërinë në raport me mekanizmat për ankesat e kompanisë.

Shpresojmë se ky publikim do të përdoret që kompania juaj të fillojë të bëjë kontrollimin paraprak të të drejtave të njeriut. Nëse dëshironi të kuptoni diçka më tepër, vizitoni on linë platformën tonë ose qendrën e resurseve për biznes dhe të drejta të njeriut për burime plotësuese për secilin aspekt të kontrollit paraprak të të drejtave të njeriut, përfshirë edhe praktikat e mira. Meqë kjo është fushë relativisht e re e praktikës korporatave, ju propozojmë të bashkoheni me palë të tjera të interesuara dhe t'i bashkëngjiteni forumeve për dialog dhe mësim, të organizuara për shembull nga rrjeti juaj lokal i Marrëveshjes globale që në mënyrë plotësuese të zhvilloni qasjen tuaj drejt kontrollit paraprak. Shpresojmë se do t'ju pëlqejë mësimi dhe fakti se jeni kyçur në këtë fushë interesante dhe Ju urojmë shumë sukses në të ardhmen.

Për më tepër informata vizitoni: www.konekt.org.mk

